

PAKR.nr.445/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A.Z. nga fsh. ..., Komuna e Istogut, për shkak të kërkesës për bashkim të dënimeve, duke vendosur përkitazi me ankesën e të dënuarit A.Z., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, KP.nr.14/2018, të datës 14.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 19.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së të dënuarit A.Z., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, KP.nr.14/2018, të datës 14.05.2018, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që duke i marrë si të vërtetuara dënimet e shqiptuara me aktgjykimi të formës së prerë, me shenjën P.nr.3/15 të dt. 29.04.2015, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.249/15 të dt. 17.09.2015, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjet dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, dhe me shenjën P.nr.506/16 të dt. 30.03.2017, i plotfuqishëm nga dt. 26.04.2017, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim, bazuar në dispozitat e nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit, të dënuarin A.Z., e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 1 (një) muaj, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.10.2014 e deri më 15.01.2015, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, dënim ky me gjobë të cilin nëse i dënuari refuzon ta paguajë, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Pjesa tjetër e aktgjykimit të ankimuar mbetet e paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, KP.nr.14/2018, të datës 14.05.2018, është aprovuar kërkesa e të dënuarit A.Z., për bashkimin e dënimeve të shqiptuara me aktgjykimet e formës së prerë, ashtu që janë ndryshuar aktgjykimet e formës së prerë: P.nr.3/2015 të datës 29.04.2015, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.249/15 të dt. 17.09.2015, me të cilin të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, dhe aktgjykimi tjetër i formës së prerë, P.nr.506/16 i dt. 30.03.2017, i cili është bërë i plotfuqishëm më dt. 26.04.2017, aktgjykim ky me të cilin të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj dhe dënimi me gjobë në shumë prej 400 €, për të cilin dënim – pra, dënimi me gjobë, gjykata e shkallës së parë, ia ka kushtëzuar me konstatim se dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një viti nuk kryen vepër të re penale, ashtu që me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimit për veprat penale bashkim, bazuar në dispozitat e nenit 80 të KPK-së, të dënuarit, gjykata e shkallës së parë, i ka shqiptuar dënimin unik me burgim me kohëzgjatje prej 3 vjet e një muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 €, dënim ky që nëse i dënuari e refuzon ta paguajë, pra, dënimin me gjobë, atëherë, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur i dënuari A.Z., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet një dënim shumë më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pra, konform dispozitave ligjore për bashkim të dënimeve.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dënuarin A.Z. dhe mbrojtësin e tij av. I.O.. Në seancën e kolegjit ishin prezentë i dënuari A.Z., i cili pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore ngelin në tërësi pranë propozimeve si në ankesë. Në seancën e kolegjit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as mbrojtësi i të akuzuarit I.O..

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës PPA/I.nr.421/2018, të dt. 03.10.2018, ka propozuar që ankesa e dënuarit A.Z., të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet dënim konform dispozitave ligjore për bashkimin e dënimeve.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk është kontestuar, prandaj, Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi vetëm në kuptim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore, përkitazi në këtë bazë ankimore janë të bazuara. Në ankesën e të dënuarit A.Z., theksohet se vendimi për dënim nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase i njëjti nuk është shqiptuar në përputhshmëri me dispozitat e nenit 80 të KPK-së, ku në mënyrë të detajuar rregullohet çështja e shqiptimit të dënimeve për veprat penale në bashkim, ku në rastin konkret janë paraparë edhe rregullat për bashkimin e dënimeve të shqiptuara për veprat penale në bashkim dhe atë pikërisht me dispozitat e nenit 80 të KPK-së, parashihet shprehimisht se në rast të bashkimit të dënimeve për veprat penale për të cilat nuk është shqiptuar dënimi unik me burgim, atëherë aktgjykimet e formës së prerë, mund të ndryshohen dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim unik, prandaj, i dënuari edhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të lartë cekura të dënuarit janë të bazuara, por duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së arë, gabimisht i ka zbatuar dispozitat e nenit 80 të KPK-së, të parapara për bashkimin e dënimeve të shqiptuara për disa vepra penale, ngase, në dispozitat e nenit 80 të KPK-së, shprehimisht është bërë rregullimi i procedurës për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim, ku është paraparë bashkimi i dënimeve të shqiptuara me burgim si dhe atyre me gjobë, mirëpo, jo edhe bashkimi i dënimeve të shqiptuara me kusht, sikur që ka ndodhur në rastin konkret me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, pastaj, po me aktgjykimin në fjalë, nuk është marrë parasysh fare koha e kaluar në arrest shtëpiak, e cila të dënuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë, P.nr.249/15 të dt. 17.09.2015, ku me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përveç dënimit të shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 vjet dhe dënimit me gjobë në shumë prej 300 €, i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 15.10.2014 e gjerë më dt. 15.01.2015.

Në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike sipas përmbajtjes së aktgjykimit të ankimuar por edhe aktgjykimeve të formës së prerë, në shkresat e lëndës, për të cilat i dënuari ka kërkuar bashkimin e dënimeve, rezulton se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore – DKR në Mitrovicë, P.nr.3/15 të dt. 29.04.2015, i cili është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.249/15 të dt. 17.09.2015, të dënuarit, gjegjësisht, atëherë të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, në të cilin dënim, pra, dënimin e shqiptuar me burgim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 15.10.2014, e gjerë më dt. 15.01.2015, ndërsa, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një vjet nuk kryen vepër tjetër penale, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar gjatë zbatimit të dispozitave të nenit 80 të KPK-së, në

rastin konkret gjatë shqiptimit të dënimit unik ka marrë parasysh edhe dënimin e kushtëzuar të shqiptuar me gjobë nga gjykata e shkallës së parë, që do të thotë se bazuar në dispozitat ligjore të nenit 80 të KPK-së, të dënuarit nuk mund t'i llogaritet në dënimin unik edhe dënimi i kushtëzuar.

Prandaj, duke pasur parasysh dispozitat ligjore në fjalë dhe lartësinë e dënimeve të shqiptuara me aktgjykimet e formës së prerë, për të cilat edhe është bërë bashkimi i dënimeve, rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar dispozitat e nenit 80 të KPK-së, për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim, ngase, në dënimin e shqiptuar unik ka përfshirë gabimisht edhe dënimin me gjobë në shumë prej 400 €, dënim ky i cili nga gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e plotfuqishëm P.nr. 506/16 të dt. 30.03.2017, gjegjësisht i formës së prerë më dt. 26.04.2017, ka qenë i kushtëzuar dhe i njëjti nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një viti nuk kryen veprë tjetër penale, që do të thotë se në rastin konkret dënimi me gjobë mund të përfshihet në dënimin unik vetëm pasi që i njëjti të revokohet nga gjykata kompetente, për çka, kjo gjykatë e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të dënuarit i shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 1 (një) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, pra, konform dispozitave të nenit 80 të KPK-së.

Gjithashtu, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 83 të KPK-së, ku parashihet se në dënimin e shqiptuar duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak dhe çdo periudhë tjetër e heqjes së lirisë përkitazi me veprën penale në fjalë, kjo gjykatë gjeti se të dënuarit po ashtu, nuk i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.10.2014 e gjer më datën 15.01.2015, kohëzgjatje kjo e cila të dënuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 vjet, me aktgjykimin e formës së prerë P.nr.3/15 të dt. 29.04.2015, prandaj, Gjykata e Apelit, tani duke vepruar sipas detyrës zyrtare, e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim dhe në dënimin unik të shqiptuar me burgim prej 3 (tre) vjet e 1 (një) muaj, të dënuarit i llogariti edhe kohën e kaluar në arrest shtëpiak.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.445/2018, më datën 19.10.2018

**Procesmbajtëse,
Kimete Veseli**

Anëtarët e kolegjit,

1. _____

Xhevdet Abazi

2. _____

Abdullah Ahmeti

**Kryetare e kolegjit,
Tonka Berishaj**

